



PROPOZIM

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) e Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe në lidhje me nenin 42, paragrafi (9), pikën 6) dhe nenin 172, paragrafi (3) i Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për numrin kryesues të ofruesve të shërbimeve pagesore dhe standardeve të ndërtimit të llogarive pagesore

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet:

- caktimi i numrit kryesues të ofruesve të shërbimeve pagesore nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) dhe
 - standardi mbi ndërtimin e llogarive pagesore të cilat i posedojnë ofruesit e shërbimeve pagesore të cilëve Banka Popullore u ka ndarë numra kryesues.
2. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen respektivisht edhe në ndërtimin e llogarive për shlyerje të cilat Banka Popullore i hap në pajtueshmëri me ligjin.

II. CAKTIMI I NUMRIT KRYESUES TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE PAGESORE

3. Numri kryesues i ofruesit të shërbimeve pagesore:

- është numër identifikimi fiks, i vetëm dhe i papërsëritshëm i ofruesit të shërbimeve pagesore;
- përbëhet nga 3 karaktere numerike (n1, n2, n3);
- është i publikuar në listën e numrave kryesorë të cilën e udhëheq dhe publikon Banka Popullore në ueb-faqen e saj;
- përdoret për ndërtimin e shenjës (numrit) të vetme të identifikimit të llogarisë pagesore të shfrytëzuesit të shërbimeve pagesore, të cilën e hap dhe e udhëheq ofruesi i shërbimeve pagesore.

4. Numri kryesues i ofruesit të shërbimeve pagesore jepet me kërkesë të ofruesit të shërbimeve pagesore të dorëzuar në Bankën Popullore.

III. STANDARDET E NDËRTIMIT TË NUMRIT TË LLOGARISË PAGESORE TË CILËN E MIRËMBAN OFRUESI I SHËRBIMEVE PAGESORE

5. Numri i llogarisë pagesore të cilën e mirëmban ofruesi i shërbimeve pagesore dhe nëpërmjet së cilës realizohen transaksionet pagesore në denarë shëhohet vetëm në

formë numerike, e cila ndërtohet me përdorimin e standardit BBAN-it vijues (ang. BBAN = Basic Bank Account Number), të përbërë nga tre pjesë, me format BBBCCCCCCCCCKK, prej ku:

- BBB = numër fiks i ofruesit të shërbimeve pagesore (tre vende numerike) i cili është numri kryesues i ofruesit të shërbimeve pagesore për realizimin e transaksioneve pagesore, të cilin e ndan Banka Popullore;
- CCCCCCCCCC = numri i llogarisë pagesore (10 vende numerike) i poseduesit të llogarisë pagesore i cili përcaktohet nga ana e ofruesit të shërbimeve pagesore; dhe
- KK = numri kontrollues (dy vende numerike) është numër që llogaritet nga vargu prej 13 shifrash (numri kryesues i ofruesit të shërbimeve pagesore dhe numri i llogarisë pagesore) sipas standardit ndërkombëtar ISO 7064, MODUL 97. Numri kontrollues fitohet me atë që vargu i 13 shifrave të para shumëzohet me 100, numri i fituar pjesëtohet me 97, ndërsa pjesa e mbetur zbritet nga numri 98. Rezultati i fituar i shprehur me dy shifra paraqet numrin kontrollues. Shenja numerike e llogarisë pagesore nga paragrafi (1) përdoret në formë elektronike, ekskluzivisht si varg prej pesëmbëdhjetë shifrash.

Në dokumentet e shkruara dhe të shtypura lejohet regjistrimi i shenjës numerike të llogarisë pagesore në të tre pjesët e përcaktuara me paragrafin 1 të kësaj pike, të ndara me vizë.

6. Numri i llogarisë pagesore të cilën e mirëmban ofruesi i shërbimeve pagesore dhe nëpërmjet së cilës realizohen transaksionet pagesore në valutë ndryshe nga denari, ndërtohet nga ofruesi i shërbimeve pagesore me përdorimin e standardit ndërkombëtar ISO 13616 dhe është IBAN standard (ang. IBAN = International Bank Account Number), ky me format MKkk BBB CCCCCCCCCC KK, dhe atë:

- MK = dy karakteret e para (shenjë me dy shkronja të mëdha latine dhe përdoret MK si kod fiks për Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pajtim me standardin ndërkombëtar ISO 3166 – 1);
- kk = 07 (dy vende numerike për të cilat shfrytëzohet numër i llogaritur algoritmikisht sipas standardit ndërkombëtar ISO 7064, MODUL 97), dhe
- BBAN = në pajtim me pikën 5) të këtij vendimi.

7. Numri i llogarisë pagesore i ndërtuar në pajtueshmëri me kërkesat nga pika 5) dhe 6) e këtij vendimi, përbëhet nga shifra arabe nga 0 deri tek 9 dhe shkronja të mëdha latine nga A deri tek Z, dhe përdoret si shenjë e vetme identifikimi në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore.

8. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar të ndërtojë numër të llogarisë pagesore në pajtim me kërkesat nga pika 5) dhe 6) e këtij vendimi, nëse e njëjta shfrytëzohet për kryerjen e transaksioneve pagesore me përdorim të transferit kreditor, ose debitimit direkt nga, ose, në llogarinë pagesore tek një ofrues tjetër i shërbimeve pagesore, brenda ose jashtë vendit.

9. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar që për çdo llogari pagesore të hapur në pajtim me pikën 7) të këtij vendimi:

- të ndërtojë numër të llogarisë pagesore në pajtim me kërkesat nga pikat 5) dhe 6) të këtij vendimi në ditën e hapjes së llogarisë pagesore;
- në formë të shkruar të shkëmbejë numrin e llogarisë pagesore nga nënpika 1) e kësaj pike, me poseduesin e llogarisë pagesore; dhe
- në formë të shkruar, me poseduesin e llogarisë pagesore të shkëmbejë numrin e llogarisë pagesore të cilin e ka ndërtuar në pajtim me pikat 5) dhe 6) të këtij vendimi, nëse arrihen rrethanat e përfshira me dispozitat nga pika 10), 11), 12) dhe 13) të këtij vendimi.

10. Në rast të bashkimit të ofruesve të shërbimeve pagesore, numri i llogarisë pagesore i cili është ndërtuar në pajtim me këtë vendim mund të shfrytëzohet për kryerjen e transakcioneve pagesore për një periudhë maksimale prej një viti nga momenti i bashkimit. Ofruesi i shërbimeve pagesore i krijuar nga bashkimi është i detyruar që përdoruesve të shërbimeve pagesore të ofruesve të shërbimeve pagesore të cilët janë bashkuar, t'iu ndërtojë numër të ri të llogarisë pagesore, në pajtim me këtë vendim, jo më vonë se një vit nga momenti i bashkimit.

11. Në rastin e përvetësimit të një ofruesi të shërbimeve pagesore me një ofrues tjetër të shërbimeve pagesore, numri i llogarisë pagesore të cilin në pajtim me këtë vendim e ka përcaktuar ofruesi i shërbimeve pagesore i cili është përveësuar nga një ofrues tjetër, mund të shfrytëzohet për kryerje të transakcioneve pagesore brenda një periudhe prej një viti nga momenti i përvetësimit. Ofruesi i shërbimeve pagesore me të cilin është përvetësuar një ofrues tjetër, gjatë asaj periudhe, për qëllime të kryerjes së transaksioneve pagesore, mund të përdorë numrin kryesues të ofruesit të shërbimeve pagesore i cili është përvetësuar në të. Ofruesi i shërbimeve pagesore me të cilin është përvetësuar një ofrues tjetër, është i detyruar që përdoruesve të mëparshëm të shërbimeve pagesore të ofruesit të shërbimeve pagesore i cili është përvetësuar, t'iu përcaktojë numër të ri të llogarisë pagesore, në pajtim me këtë vendim, jo më vonë se një vit nga momenti i përvetësimit.

12. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili merr urdhërpagesë në favor të një numri llogarie pagesore të një ofruesi të shërbimeve pagesore që është bashkuar me një ofrues tjetër të shërbimeve pagesore, ose një ofruesi të shërbimeve pagesore që është bashkuar me tjetër ofrues të shërbimeve pagesore, duhet të mundësojë, në pajtim me rregulloret përkatëse, realizimin e transakcionit pagesor në favor të ofruesit të shërbimeve pagesore që është krijuar nga bashkimi, apo ofruesit të shërbimeve pagesore në të cilin është përvetësuar ofruesi tjetër i shërbimeve pagesore, në periudhë kohore brenda një viti nga momenti i bashkimit, respektivisht bashkimi i ofruesit të shërbimeve pagesore, edhe atë në rast kur realizimi i transakcioneve të tilla pagesore mundësohet nga ana e sistemit pagesor në të cilin ai merr pjesë.

13. Nëqoftëse ofruesi i shërbimeve pagesore që është krijuar nga bashkimi, ose ofruesi i shërbimeve pagesore në të cilin është përvetësuar një ofrues tjetër i shërbimeve pagesore, ka caktuar tashmë numër të ri llogarie pagesore për përdoruesit e mëparshëm të shërbimeve pagesore të ofruesit të shërbimeve pagesore që është bashkuar apo përvetësuar në pajtim me pikën 5) dhe 6) të këtij vendimi, transaksioni pagesor i pranuar nga pika 12) e këtij vendimi do të evidentohet në favor të numrit të ri të llogarisë pagesore të atij përdoruesi të shërbimeve pagesore.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

14. Numrat kryesues të ofruesve të shërbimeve pagesore të cilat Banka Popullore i ka përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë të vlejné edhe më tej.
15. Numrat e llogarive pagesore të cilët ofruesit e shërbimeve pagesore i kanë ndërtuar dhe shkëmbyer me përdoruesit e shërbimeve pagesore para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë të vlejné edhe më tej.
16. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e kreut III të këtij vendimi, jo më vonë se data 30 qershor 2024, dhe duke e bërë këtë, të shkëmbejnë numrin e ri të llogarisë pagesore me mbajtësin, neqoftëse numri i mëparshëm është ndërtuar në mënyrë të ndryshme nga dispozitat e kreut III të këtij vendimi.
17. Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi ndalon së vlejturei Vendimi për përshkrimin e standardit mbi ndërtimin e llogarive të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor dhe ndarja e numrave kryesues të bartësve të qarkullimit pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/07).
18. Ky vendim hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga 1 janari 2023.

V nr. p.02-15/XXII-11/2022
28.12.2022
Shkup

Guvernatorja dhe kryetarja e
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angelovska-Bezhoska